

## RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

### Periudha e Raportimit Janar- Dhjetor 2017

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, të ndryshuar Udhëzimit Nr. 1, datë 15.1.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, ushtron aktivitetin buxhetor në programin buxhetor “Shërbime të tjera”.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me objektivat e STKKU-së, duke patur si synim një përdorim më eficient të këtyre burimeve sipas programimit të bërë për vitin 2017.

**I.Fondet buxhetore** të ndryshuara për vitin 2017 për STKKU-në në total janë 33.600 mijë lekë prej të cilave 32,100,000 lekë janë shpenzimet korente dhe 1.500 mijë lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për 12 mujorin e vitit 2017.


**KRYEMINISTRIA  
SEKRETARIATI TEKNIK I KESHILLIT  
KOMBETAR TE UJIT**

**Pasqyra Nr.1**

### SHPENZIMET KORENTE JANAR - 31 DHJETOR 2017

Entiteti Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Buxheti vjetor 2017 i rishikuar	Shpenzimet Faktike Janar-Dhjetor 2017	Diferenca	% realizimit
001	87	1087016	01	01150	6000000	3535	23.100.000	20.670.270	2.429.730	89
001	87	1087016	01	01150	6010000	3535	4.000.000	3.316.593	683.407	83
001	87	1087016	01	01150	6020000	3535	5.000.000	3.673.787	1.326.213	73
<b>TOTALI</b>							<b>32.100.000</b>	<b>27.660.650</b>	<b>4.439.350</b>	<b>86</b>

Një paraqitje grafike e realizimit të treguesve sipas artikujve jepet sim ë poshtë:



Referuar tabelës nr. 1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për 12 mujorin e vitit 2017 është në masën 86%, në raport me totalin e vitit 2017. Faktorët që kanë ndikuar në këtë mosrealizim janë të analizuar si më poshtë vijon:

- Në artikullin 600 & 601 “Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqerore”** fondet janë realizuar, respektivisht nga 89% dhe 83% e buxhetit vjetor. Diferenca prej 2.400 mijë lekë të porealizuara është krijuar pasi këtë vit kemi pasur një strukturë rreth 85% të numrit total të punonjësve, pasi një vend është vakant, dy punonjëse kanë qënë me leje lindje, një punonjës pezullim të përkohshëm për shkak të kandidimit si dhe shkëputja e drejtuesit të institucionit, Sekretarit Kombëtar të Ujit për tremujorin e fundit të vitit.
- Në artikullin 602 “Shpenzime Operative”** ku buxheti vjetor ishte 5.000 mijë lekë, fondet janë realizuar 3.674 mijë lekë ose në masën 73%. Mos realizimi në masën 1.326 mijë lekë vjen si pasojë e faktit të kufizimeve për përdorimin e fondeve për trajnime, dieta dhe konferenca të cilat zënë një masë të konsiderueshme të buxhetit të vënë në dispozicion për vitin 2017, pasi një pjesë e personelit ka përfituar trajnime apo pjesëmarrje në aktivitete të cilat janë financuar nga donatorët.

**Tabela 2. Shpenzime Kapitale**

KRYEMINISTRI

A


SEKRETARIATI TEKNIK I KESHILLIT KOMBETAR TE UJIT

SHPENZIMET FAKTIKE NË INVESTIME JANAR- DHJETOR 2017

Lekë

Entiteti Qeverisjes	Ministria e linjes	Kodi institucioni t	Kapitulli	Programi	LLogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Buxheti vjetor 2017	Shpenzimet Janar-Dhjetor 2017	Diferenca	% realizimit	Kodi i Projektit	Emertimi i Projektit
001	87	1087016	01	01150	2310000	3535	700.000	419.160	280.840	59,88	M870023	Paisje te tjera zyre
001	87	1087016	01	01150	2310000	3535	120.000	116.100	3.900	96,75	M870103	Akses Kontroll
001	87	1087016	01	01150	2310000	3535	680.000	-	680.000	0	M870160	Paisje elektronike
001	87	1087016	01	01150	2310000	3535	-	-	-		M870057	Projekti Studim Fizibiliteti
<b>TOTALI</b>							<b>1.500.000</b>	<b>535.260</b>	<b>964.740</b>	<b>36</b>		

Grafikisht realizimi i investimeve jepet në tabelën e mëposhtme:



### Realizimi i investimeve për 12 Mujorin 2017

Referuar tabelës nr. 2, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për 12 mujorin e vitit 2017, është në masën 36 % e fondit të planifikuar, ndërsa si projekte realizimi është si me poshte vijon:

Projekti me kod M 870057 “Studim fizibiliteti për përcaktimin e fushave të kërkimit shkencor për burimet ujore dhe menaxhimin e risqeve” nuk u realizua, pasi fondi u tërhoq nga Ministria e Financave.

Projekti me kod M 870018 “**Paisje elektronike**”, nuk është realizuar, pasi procedurat e prokurimit dështuan, për shkak se operatorët nuk iu përgjigjën kërkesave teknike të kërkuara nga institucioni.

Projekti me kod M 870103 “**Akses Kontroll**”, është realizuar 100%.

Projekti me kod M870023 “**Paisje te tjera zyre**” është realizuar 60%

## **II. Objektivat për vitin 2017**

1. Ndërtimi i një sistemi total të integruar për drejtimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve ujore;
2. Ndërtimi i një sistemi të integruar të informacionit në fushën e ujit;
3. Mirëmanaxhimi kombëtar i burimeve ujore;
4. Mirëadministrimi dhe mbrojtja e ujrave ndërkufitare;
5. Mirëfunksionimi i Këshillave të Baseneve Ujore;
6. Optimizimi i vendimarrjeve të KKU-së për përdorimin e burimeve ujore;
7. Ndërtimi i sistemit të integruar të burimeve njerëzore, financiare dhe aseteve në sektorin e ujit.

Realizimi i objektivave nënkupton realizimin e aktiviteteve dhe produkteve, të pasqyruara në PBA për vitin buxhetor 2017.

Në funksion të realizimit të objektivave janë kryer aktivitetet dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

**Produkti A: Hartimi dhe Miratimi i Programit Kombëtar Sektorial dhe hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e tij,** është realizuar në masën 90%.

Është përfunduar drafti i PKS-së i cili është konsultuar në nivelin e grupeve tematike, në nivel lokal si dhe me të gjitha grupet e interesit dhe donatorët. Gjithashtu drafti final është prezantuar në KKU dhe në takime respektive me minsitritë e linjës përgjegjëse për një fushë të caktuar të lidhur me menaxhimin e ujit. Është përgatitur draft VKM-ja dhe relacioni përkatës ku janë reflektuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra nga institucione të ndryshme. Pritet që dokumenti të përcillet për miratim.

**Produkti B: Implementimi i Programit Kombëtar Sektorial nëpërmjet zbatimit të planeve të veprimit i detajuar për sektorin.**

Realizimi i produktit është në masën 90%.

Ka përfunduar draft plani i veprimit 2018-2020, i cili është dërguar për konsultim tek grupet tematike dhe pushteti lokal. Pritet të dakortësohet me të gjithë aktorët për ta përfshirë në PBA-në përkatëse. Ka përfunduar hartimi i draftit të planit të veprimit 2018-2020. Dokumenti është finalizuar me kontributin dhe plotësimet e anëtarëve të grupeve tematike. Plani i veprimit, është konsultuar me të gjitha grupet e interesit. Janë zhvilluar takime konsultimi në nivel rajonal:

Rajoni Tiranë, datë 29.5.2017

Rajoni Vlorë, datë 30.5.2017

Rajoni Korçë, datë 1.6.2017

Rajoni Shkodër, datë 2.6.2017

Një sërë takimesh janë zhvilluar me të gjithë përfaqësuesit e lartë të ministrive të linjës, ku është prezantuar në detaje drafti final i PKS-së, Plani i Veprimit si dhe objektivat për sektorin e ujit deri në vitin 2030.

Në Qershor 2017 është zhvilluar një mbledhje me donatorët kryesore në sektorin e ujit ku u diskutua edhe mbi draftin final të PKS-së dhe parashikimet për sektorin, deri në vitin 2030 së bashku me aktivitetet konkrete në Planin e Veprimit. Të dy këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare të STKKU-se: [www.stkku.gov.al/publikime](http://www.stkku.gov.al/publikime)

Ndërkohë, është përgatitur edhe akti nënligjor për miratimin final të PKS-së dhe Planit të Veprimit. Gjithashtu dokumentet i janë përcjellë, në variantin final të tyre të gjitha ministrive të linjës për mendime apo plotësime finale, pas procesit të konsultimit.

#### **Produkti C: Ndjekja e mbledhjeve të nëngrupeve tematike**

Për këtë periudhë janë organizuar 10 mbledhje nga 24 të planifluara me nëngrupet tematike për të diskutuar mbi finalizimin e PKS-së dhe Planit të Veprimit 2018-2020.

Aktualisht pritet miratimi i tyre.

#### **Produkti D: Organizimi i mbledhjeve të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për ujë (GMIP), është realizuar në masën 50%.**

Më datë 22.2.2017 është organizuar mbledhje e KKKU-së ku është prezantuar drafti i PKS-së. Duke qënë se PKS është ende në proces konsultimesh nuk është bërë mbledhje e GMIP-së ku pjesëmarrës janë edhe donatorët. Megjithatë me datë 15.3.2017 në ambasadën Gjermane përpara të gjithë donatorëve është prezantuar drafti i PKS-së. Mbledhje e GMIP-së do të bëhet kur dokumenti të jetë në fazë miratimi.

#### **Produkti E: Ndjekja e Kadastrës Kombëtare të burimeve ujore dhe hartimi i inventarit të burimeve ujore është realizuar rreth 100%.**

Ky projekt është dorëzuar nga konsulenti në MBZHR, por popullimi me të dhëna dhe instalimi i softëve nuk ka përfunduar ende. Nga STKKU-ja është marrë pjesë në workshopin e organizuar për Kadastrën ku janë dhënë edhe komentet përkatëse. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti janë organizuar disa takime me përfaqësues të MBZHR ku është diskutuar mbi komentet e STKKU-së për përgatitjen e draft VKM-së për funksionimin dhe mirëmbajtjen e Kadastrës Kombëtare të burimeve ujore si dhe me MD, KM. Janë organizuar takime me përfaqësues të Bankës Botërore për problematikat e implementimit të Kadastrës.

#### **Produkti F: Hartimi dhe monitorimi i standardeve, rregullave dhe përputhshmërinë e informacionit në bashkëpunim me ASIG dhe institucionet e tjera qëndrore dhe vendore, është realizuar në masën 100%.**

Janë realizuar dy takime me përfaqësues të ASIG për të përshtatur standartin dhe për të ndjekur procesin e miratimit të Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore nga Bordi i Informacionit Gjeohapsinor (BIG). Referuar kërkesës tonë ASIG-u dhe MBZHR-ja kanë zhvilluar një takim në lidhje me draft VKM-në për Kadastrën si dhe hapat përkatëse për miratimin e platformës. Kemi studiuar bazën ligjore dhe kërkohet miratimi edhe nga BIG-u për platformën GIS të Kadastrës si dhe nga AKSHI.

#### **Produkti G: Ndjekja, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore. Për realizimin e këtij produkti është punuar në rreth 40% e tij në raport me planin**

vjetor. Takime për përmirësimin e variantit përfundimtar të shpërndarë për mendim dhe komente nëpër institucione.

**Produkti H: Ndjekja e procesit të hartimit, miratimi dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Drin-Bunë dhe Seman.**

Është realizuar rreth 45% e produktit. Janë bërë takime për plotësimin e draftit paraparak të dorëzuar nga konsulenti si dhe për ecurinë e procesit konform afateve të kontratës.

**Produkti M: Ndjekja e mardhënieve me vendet fqinje për administrimin e ujërave ndërkufitare.** Është realizuar në masën 100% e totalit, pjesmarrje në mbledhjet e KPAUN, projektet e DCG si pjesë e komitetit drejtues dhe grupeve të punës, workshope të ndryshme me këtë fokus. Jemi akoma në pritje të informacionit nga institucionet respektive të dokumentacionit ligjor që disponojnë në lidhje me mardhëniet ndërkufitare.

**Produkti N: Organizimi i mbledhjeve të KKU-së dhe zbatimi i detyrave të lëna nga ky organ** Janë realizuar 2 mbledhje të KKU-së nga 6 mbledhje të planifikuara për vitin 2017.

Është në proces përgatitje të materialit përfundimtar për mbledhjen e rradhes sipas axhendës së përcaktuar.

**Produkti O: Kontroll i veprimtarisë të organeve vendore të Menaxhimit të Burimeve Ujore.**

Vijon procesi, nga 6 kontrole janë realizuar 100%, duke tejkalluar numrin e kontroleve në basene. Një takim dhe tre mbledhje KBU-je për Basenin Drin-Bunë, dy takime dhe dy mbledhje KBU-je për Basenin Mat, një takim për Basenin Ishëm-Erzen, tre mbledhje KBU-je Baseni Shkumbin, tre mbledhje Baseni Seman dhe 2 mbledhje Baseni Vjosë. Katër takime dhe tre mbledhje KBU Drin-Bunë, dy takime dhe katër mbledhje KBU Mat, dy takime dhe 12 mbledhje KBU Ishëm-Erzen, 4 mbledhje dhe një takim KBU Shkumbin. Pesë mbledhje KBU Seman, 3 mbledhje dhe një takim KBU Vjose, një takim me 6 prefektet në ambjentet e STKKU-së.

**Produkti P: Përcaktimi i zonave të ruajtjes referuar ligjit 111/2012**

Është realizuar në masën 5% pasi është në fazën e korespondencës me AKZM për hartimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura si pjesë përbërëse e planeve të menaxhimit. Është zhvilluar takim me konsulentin që po harton planet e menaxhimit Drin-Bunë dhe Seman për njohjen me problematikën.

**Produkti Q: VKKU për shpalljen e trupave të caktuara ujore si artificiale dhe tepër të modifikuar,** është realizuar në masën 60%. Janë realizuar 3 takime nga 5 takime të planifikuara dhe workshopi i organizuar nga GIZ për njohjen me situatën.

**Produkti R: VKKU për veprimtari ndërtimore në brigje**

Është realizuar 1 takim nga 3 të planifikuara, pra rreth 30 % e produktit. Mbahet korespondencë me MBZHR në vazhdimësi për problematikën, takim me AKPT për harmonizimin e planeve të detajuara vendore me planet e menaxhimit.

**Produkti S: Modelemi, implementimi dhe monitorimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve financiare,** është realizuar rreth 90%. Janë kryer takimet e radhës me ministrinë e

linjës dhe institucionet e tjera. Është siguruar informacion nga donatorët që kanë investuar në fushën e ujit dhe përgatitja e drafteve të buxhetimit të integruar të sektorit.

Korespondenca me ministritë e linjës, Departamentin e Koordinimit, Zhvillimit dhe Financimit e Ndhmës së Huaj dhe me grupet tematike për të përditesuar informacionin lidhur me buxhetin e PKS-së.

**Produkti SH: Modelemi, implementimi dhe monitorimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore** është realizuar rreth 90% e produktit. Janë organizuar takime me përfaqësues të grupeve tematike dhe përfaqësues të ASPA për krijimin e mundësive të organizimit të trajnimeve të punonjësve të sektorit të ujit.

**Produkti T: Blerja e paisjeve për mbarëvajtjen e punës dhe realizimin e objektivave në STKKU.** Realizimi i këtij produkti është në masën 36% e totalit. Është realizuar 100% blerja e sistemit të kartës së aksesit, për hyrjen në institucion, paisjet e zyrave janë realizuar në masën 60%, ndërsa pajisjet elektronike nuk u realizuan për shkak të tërheqjes së operatorëve për mospërbushjen e specifikimeve teknike.

**Produkti U: Projekte ne ndihme të institucioneve që merren me menaxhimin e ujit, (Studim Fizibiliteti).** Është procedurë e anuluar për shkak se fondi në dispozicion u tërhoq nga Ministria e Financave për në destinacion tjetër dhe parashikohet që të kryhet për vitin 2018.

**SEKRETARI KOMBËTAR I UJIT**

**GERTA LUBONJA**